



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria –Vlada-Government*

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Komisioni Ministror për Themelimin e Odës së Arkitektëve dhe  
Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit

**RAPORTI I MBIKEQYRJËS SË PUNËS SË ORGANEVE TË ODËS SË  
INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**Prishtinë**  
**Shkurt, 2026**

I nderuari kryetar i Odes së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës, z. Rapuca,  
Të nderuar anëtar të: Bordit Drejtues, Komisionit Disiplinor, Komisionit të Ankesave dhe të  
Kuvendit të Odës së Inxhinierëve,

Me lejoni që në emër të Komisioni Ministror për Themelimin e Odës, t'ju përshëndes dhe uroj  
për punimet në Kuvendin Vjetor të Odës.

Në përputhje me nenin 43, paragrafin 3 të Ligjit për Odat, gjatë periudhës së përkohshme të  
funksionimit të Odës, Komisioni Ministror ushtron funksionin e Komisionit Mbikëqyrës, ku  
me këtë rast ka hartuar raportin e mbikëqyrjes për punën e organeve të Odës, prej kohës së  
themelimit të saj deri në përfundim të vitit kalendarik 2025.

Meqenëse Rregullorja e Punës se Kuvendit akoma nuk ka hyre në fuqi, Komisioni Ministror  
do të sigurojë që në seancat e ardhshme vjetore të Kuvendit raporti i mbikëqyrjes të dorëzohet  
paraprakisht për shqyrtim nga anëtarët e Kuvendit, me qëllim të adresimit me kohë të gjetjeve  
eventuale.

Viti i parë i funksionimit të Odës ka qenë sfidues si për Komisionin ashtu edhe për organet e  
Odës, me të cilën janë tejkaluara shumë sfida të përbashkëta me qëllim të funksionalizimit të  
plotë të punës së organeve të Odës. Vlerësojmë punën njëvjeçare të organeve të Odës dhe  
inkurajojmë që të vazhdohet më tutje me qëllim të arritjes së objektivave të përbashkëta.

Fushëveprimi i mbikëqyrjes se Odes është fokusuar në këto aspekte:

- Kontrollin e ligjshmërisë së punës së Odës
- Mbikëqyrjen e veprimtarisë financiare të Odës dhe fondeve të sajë
- Mbikëqyrjen e punës së organeve të Odës, si dhe në aktivitetet tjera.
- Për çështje sfiduese të kemi harmonizim të ndërsjellë

Në kuadër të kontrollit të ligjshmërisë, Komisioni Ministror ka shqyrtuar dy rregulloret e  
propozuara nga Bordi Drejtues. Pas adresimit të komenteve dhe përfshirjes së tyre në draftet  
përkatëse, Ministria ka dhënë pëlqimin për miratimin e tyre nga Kuvendi. Gjithashtu, janë  
analizuar vendimet e nxjerra nga Bordi Drejtues.

Çështje që mbetet për trajtim të mëtejshëm institucional është licencimi i profileve të tjera  
profesionale. Në lidhje me vendimin për licencimin e gjeodetëve nga ana e Bordit Drejtues,  
Komisioni Ministror ka kërkuar iniciimin e procedurave për shfuqizimin e këtij vendimi, pas  
kërkesës së Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe sqarimeve ligjore të dhëna nga Ministria.

Në këtë kontekst, vlerësohet e domosdoshme që të ketë koordinim të vazhdueshëm ndërmjet  
Odës dhe Ministrisë lidhur me licencimin e profileve të tjera inxhinierike, me qëllim të  
sigurimit të përputhshmërisë me fushën e ndërtimit dhe legjislacionin në fuqi.

Sa i përket mbikëqyrjes financiare, Financimi i Odës për vitin 2025 është bërë nga Buxheti i  
Republikës së Kosovës, përmes grantit qeveritar në vlerë prej 200,000 €. Shpenzimet janë bërë  
në përputhje me Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet Odës dhe Ministrisë.  
Dokumentacioni dhe pasqyrat e llogaritshme financiare mund të jenë subjekt i auditimit, sipas  
legjislacionit në fuqi.

Edukimi i vazhduar profesional është organizuar suksesshëm në vitin e parë. Për vitet në vijim kërkohet që programi i edukimit të jetë më i strukturuar, gjithëpërfshirës dhe në përputhje të plotë me Rregulloren për Edukim të Vazhduar Profesional, duke ofruar përmbajtje profesionale në fushën e inxhinierisë.

Bazuar në gjetjet e mbikëqyrjes, rekomandohet:

- Programi i edukimit të vazhduar profesional të jetë më përmbajtjesor
- Ri-shikimi i profileve të tjera të licencuara
- Koordinimin me Ministrin me qëllim që të zbatohet Ligji për Odat nga institucionet lokale dhe ato qendrore.

Në përfundim, Komisioni Ministror konstaton se veprimtaria e Odës është zhvilluar në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Për të ardhmen bashkëpunimi institucional mbetet i domosdoshëm për realizimin e objektivave të përbashkëta.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit, kontributi juaj profesional mbetet i rëndësishëm, veçanërisht në procesin e hartimit dhe plotësimit të Legjislacionit dhe akteve nënligjore përkatëse nga fusha e ndërtimit dhe se një draft i Projektligjit për ndërtimin së shpejti do të ndahet me Odën.

Ju faleminderit për vëmendjen tuaj!

Punuar nga:  
Komisioni i Ministrisë për Themelimin e Odës së Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit  
Prishtinë, Shkurt 2026